



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____._____.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “**Company Riviera 2008**” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **K81716011V**

Adresa: *Tiranë, Kamëz, rruga Nacionale Kamëz – Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1, në zonë kadastrale 2066, nr.pasurie 62/35*

Procedura e prokurimit: “**Kërkesë për Propozim - Punë**”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-73282-09-28-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Riveshje me Asfaltobeton rrugë të brendshme në qytetin Burrel, Bashkia Mat**”, me fond limit: **9 828 392** (nëntë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH** ndarë për vitin **2020** në vlerën: **6 066 666.66** (gjashtë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, ku nga grandit: **3 333 333.33** (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, dhe nga të ardhurat: **2 733 333.33** (dy milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, ndërsa për vitin **2021** në vlerën: **3 761 725.33** (tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) **lekë pa TVSH** nga grandit, me afat realizimi të punimeve: **30** (tridhjetë) **ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 82, datë 05 Tetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “**Company Riviera 2008**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K81716011V**
Vlera: **9 828 392** (nëntë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**
2. Operatorin Ekonomik: “**NIKA**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J76705047U**

Vlera: **9 590 788** (nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: "NIKA" Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J76705047U**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria "NIKA" Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma "d"/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

"1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se Deklarata mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 7 i referohet një objekti tjetër procedurë prokurimi.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Përvojë e sukseshme në realizimin e të paktën:

a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% (që i korrespondon vlerës 4 914 196 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

ose

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% (që i korrespondon vlerës 19 656 784 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- ***Në rast se punimet janë kryer me ente publike:*** Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :

i. Kontratën e Sipërmarrjes,

ii. Situacionin përfundimtar të objektit

- iii. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
 - iv. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
 - v. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8*
- *Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:*
- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
 - ii. *Situacionin përfundimtar të objektit*
 - iii. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
 - iv. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
 - v. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8*
 - vi. *Leje shfrytëzimi/ përdorimi*
 - vii. *Leje ndërtimi*

Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse zërat kryesore të punimeve kanë volume të konsiderueshme krahasimore të përcaktuara në këtë prokurim.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, Faturat Tatimore Shitje të paraqitura për të 4 (katër) kontratat nuk janë të plotësuara në të gjitha elementët e saj sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor, ku në to mungojnë nënshkrimet e blerësve, dhe në disa prej tyre nuk janë shënuar niptet e blerësve.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “a” pika 2/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesi **dëshmi nga administrata tatimore** (Drejtoria Rajonale e tatim taksave) për punësimin mesatar jo më pak se **30** (tridhjetë) **punonjës** për periudhën **Gusht 2019 – Gusht 2020**, ku përfshihet edhe Drejtuesi Teknik.*

a) Të paraqiten:

1. *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Korrik 2019 – Korrik 2020***
2. *Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2019 – Korrik 2020**, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk janë paraqitur Formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën, muajt: Gusht 2019 - Nëntor 2019 dhe për muajin: Shkurt 2020.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “c”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

c) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara për çertifikimin e punonjësve sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), të paktën punonjës me specialitetin si më poshtë:

- Teknik ndërtimi - jo më pak se 2 (një) punonjës
- Saldator – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Mekanik – jo më pak se 2 (dy) punonjës

** Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë/ diplomë që dëshmon aftësitë profesionale të punonjësit lëshuar nga një institucion i akredituar, Kartelat përkatëse të kualifikimit të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit.*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:
 - Nuk disponon 2 (dy) punonjës me specialitetin Teknik Ndërtimi
 - Për punonjësit me specialitetin Saldator dhe 2 (dy) Mekanik nuk janë paraqitur Çertifikatat/ Diplomat që dëshmojnë aftësitë profesionale të tyre.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “d”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 3 (tre) manovratorë, 1 (një) automakinist dhe 6 (gjashtë) shoferë, për të cilët të paraqiten dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) të lëshuar nga institucioni përkatës, kontrata e punës e vlefshme si dhe figurojë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon në stafin e tij 6 (gjashtë) shoferë, si dhe mungon Dëshmia e drejtimit për shoferin z. Aldo Demaj.

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6 gërmat “a” dhe “b”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 (Makineri, Pajisje)

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe pajisjet (*sipas tabelës*) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës (15 – 20 ton)	jo më pak se 2 copë
2.	Kamion vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës mbi 20 ton	jo më pak se 2 copë
3.	Kamioncine me kapacitet mbajtës (1 – 3 ton)	jo më pak se 1 copë
4.	Kamion me Vinç	jo më pak se 1 copë
5.	Fadrome me goma	jo më pak se 2 copë
6.	Autobot uji	jo më pak se 1 copë
7.	Minieskavator me zinxhir gome	jo më pak se 1 copë
8.	Rrul me vibrim mbi 12 ton	jo më pak se 1 copë
9.	Rrul me kompresor mbi 8 ton	jo më pak se 1 copë
10.	Rrul deri 3 ton	jo më pak se 1 copë
11.	Asfaltoshtruese	jo më pak se 2 copë
12.	Skarifikuere (Frezë Asfalti)	jo më pak se 1 copë
13.	Autobitumatriçe	jo më pak se 1 copë
14.	Makineri fshesë rruge	jo më pak se 1 copë
15.	Kompresor	jo më pak se 1 copë
16.	Gjenerator	jo më pak se 2 copë
17.	Matrapik	jo më pak se 2 copë
18.	Saldatrice	jo më pak se 1 copë

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 30 copë
- Jelekë Fosforeshente – jo më pak se 30 copë
- Doreza pune – jo më pak se 30 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – jo më pak se 5 copë

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:

- Kamionat e paraqitur për përmbushjen e kamion vetëshkarkues me kapacitet total mbajtës (15 – 20 ton) jo më pak se 2 (dy) copë dhe me kapacitet mbajtës mbi 20 ton jo më pak se 2 (dy) copë, nuk mund të disponohen nga operatori ekonomik pjesëmarrës, pasi: **Për Kamionët e marrë me qera me targa AA 062 GK dhe AA 645 HB, Certifikatat e lëshuar për transport mallrash në emër të qiradhënësve janë vetëm për llogari (të vet) të tyre dhe bazuar në nenin 11 pika 5.1 gërma “b”, të Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 “Për**

kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar) nuk mund të përdoret nga të tretë, që në rastin konkret nga qeramarrësi “NIKA” Sh.p.k.;

- Kamioni i marrë me qera me targa AA 755 YV, nuk është i pajisur me Çertifikatë “Për Transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit” si dhe nuk mund të përdoret për punimet objekt prokurimi, pasi është kamion malli;
- Kamioni mbi 18 ton, me targa AA 081 ZM i marrë me qera, nuk rezulton të jetë në pronësi të qeradhënësit palë në kontratë, por të një subjekti tjetër “Keli – Inerte”, ku qeradhënësi nuk ka patur tagrin ligjor për ta dhënë me qera, ku rrjedhimisht nuk mund të disponohet nga pala qeramarrëse pjesëmarrëse në tender “NIKA” Sh.p.k.;
- Nuk përmbushet kushti për disponimin e 2 (dy) Fadroma me goma, si dhe për fadomën e marrë me qira, i mungon Çertifikata e Pronësisë së mjetit rrugor në emër të qeradhënësit, si dhe Çertifikata e Kontrollit Teknik dhe Polica Sigurimi nuk shihen qartë në lidhje me vlefshmërinë e tyre;
- Nuk përmbushet kushti për disponimin e 1 (një) Autoboti uji, pasi Certifikata e lëshuar për transport mallrash në emër të qiradhënësit është vetëm për llogari të vet dhe bazuar në nenin 11 pika 5.1 gërma “b”, të Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar) nuk mund të përdoret nga të tretë, si dhe i ka mbaruar vlefshmëria e kësaj certifikate, gjithashtu nuk është paraqitur dhe Çertifikata e Pronësisë së mjetit rrugor në emër të qiradhënësit;
- Nuk përmbushet kushti për disponimin e 1 (një) Rruli me vibrim mbi 12 ton, bazuar në dokumentacionin e paraqitur;
- Nuk përmbushet kushti për disponimin e 2 (dy) Asfaltoshtruese, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se për Asfaltoshtruesen me nr. Shasie: 211143 të marrë me qera nuk është paraqitur të paktën 1 (një) foto të saj;
- Nuk përmbushet kushti për disponimin e 1 (një) Skarifikuere (Frezë Asfalti);
- Nuk përmbushet kushti për disponimin e 1 (një) Autobitumatriçe, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur rezulton se, Certifikata e lëshuar për transport mallrash në emër të qiradhënësit për automjetin me targa AA 230 UL është vetëm për llogari të vet dhe bazuar në nenin 11 pika 5.1 gërma “b”, të Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar) nuk mund të përdoret nga të tretë, si dhe Certifikata është paraqitur fotokopje, ndërsa “Bitumatriçe-ja” tjetër e paraqitur nga ana Juaj bazuar në kontratën e qiramarrjes Nr.Rep.2873, Nr.Kol.1278, datë 28.03.2020 nuk është Autobitumatriçe, por sipas fotos se paraqitur rezulton të jetë një depozite plastike ngarkuar mbi Kamioncinë lidhur me një pompë spërkatjeje në rrugë;
- Nuk përmbushet kushti për disponimin e 1 (një) Makineri fshesë rruge;

- Nuk përmbushet kushti i kërkuar në gërmën "b" të pikës 2.3.6, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se nuk disponon Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 10 copë, por vetëm 5 prej tyre dhe Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 20 copë, por vetëm 16 prej tyre.

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6 pika 4 "Shënim" dhe 5/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- *Për vërtetimin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, të paraqiten:...*

Shënim: Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira, të paraqiten: 1. Kontratë noteriale qiraje/ huapërdorje me emër objekti dhe me afate të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve dhe/ ose; 2. Kontrate noteriale qiraje/ huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht dhe mandat pagesat bankare për secilin nga automjetet dhe/ ose pajisjet e marra me qira.

- 5- Operatori ekonomik nuk duhet t'i ketë kapacitetet teknike të angazhuara në kontratat të tjera, nuk duhet të jenë të deklarurara në procedurë të shpallura fituese dhe/ose në procedurë të cilat kanë lidhje me procedurat e rindërtimit të objekteve të dëmtuara si pasojë e termetit të 26 Nëntor 2019, si dhe të deklarojë vendodhjen e mjeteve, pajisjeve për verifikim nga KVO-ja gjatë vlerësimit (*deklaratë me shkrim nga Administratori i Shoqërisë*)

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk janë paraqitur mandat pagesat bankare për secilin nga automjetet dhe pajisjet e marra me qira, si dhe deklarata e administratorit të shoqërisë për kapacitetet teknike të mara me qira nuk është e rregullt, pasi nuk tregohet adresa e saktë e vendodhjes së tyre, dhe se këto automjete dhe pajisje nuk ka pse të jenë pranë subjekteve qeradhënëse për sa kohë ato janë marrë me qira nga operatori ekonomik pjesëmarrës.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: "**Company Riviera 2008**" Sh.p.k, me seli: Tiranë, Kamëz, rruga Nacionale Kamëz – Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1, në zonë kadastrale 2066, nr.pasurie 62/35, me numër Nipt-i: **K81716011V**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **9 828 392** (nëntë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** (*Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike*), me adresë: *Sheshi "Ahmet Zogu", Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **13.10.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor